



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:078054
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06282860

KF.nr.699/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar –administrativ të paditësit N.T.P UNIVERZUM COMMERCE TE LUZHA, me numër unik identifikues 810638421 dhe me seli në Ferizaj, kundër të paditurës Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas padisë së paditësit për Anulim Vendimi, Objekt Kontesti rivlerësim doganor, vlera e kontestit 3,783.95 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor – publik të datës 20.09.2024, të mbajtur në prani të pronarit të paditësit K.L. dhe përfaqësueses së të paditurës Albërije Hoxha Dedushaj, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Universum Commerce të Lluzha” Sh.p.k. me seli në Ferizaj.
- II. ANULOHET aktvendimi nr.01.03.2.2/25998 i datës 14.02.2022 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. HEDHET POSHTË kërkesëpadia e paditësit “Universum Commerce të Lluzha” Sh.p.k. me seli në Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të obligohet Dogana e Kosovës t’ia kthej mjetet e paguara në shumë prej 3.783.95 (tre mijë e shtatëqind e tetëdhjete e tre euro e nëntëdhjetë e pesë cent), pasi që për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia.
- IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi N.T.P UNIVERZUM COMMERCE TE LUZHA, me datë 19.04.2022, ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi i të paditurës Dogana e Kosovës me nr.01.03.2.2/25998 i datës 14.02.2022. Në seancën e datës 20.09.2024 ka deklaruar se me datë

04.07.2024 nga Gjykata Komerciale ka pranuar aktgjykimin e lëndës KF.nr.491/22 me të cilin është aprovuar kërkesëpapia për të njëjtën çështje respektivisht aktvendim të njëjtë me nr.05.2.1/575;768/2021 i datës 29.04.2021 dhe shumën e paguar më tepër në vlerë prej 3.783.95, një kopje të aktgjykimit KF.nr.491/22 i ka dorëzuar gjykatës për trajtim të mëtutjeshëm. Më tej ka theksuar se kërkojë nga gjykata që të marrë vendim ashtu që të më kthehet shuma e paguar më tepër në vlerë prej 3,783.95 euro. Po ashtu ia lë gjykatës të vendos nëse kjo padi tashmë është vendosur nga shkalla e parë me të cilin ia kam dorëzuar gjykatës në këtë seancë.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 06.08.2024, e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit duke konstatuar se aktvendimi i atakuar me këtë padi, është marrë konform të gjitha dispozitave ligjore dhe ajo në të cilën pretendon pala se është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. E paditura pasi ka pranuar padinë dhe pretendimet e paraqitura i ka trajtuar të njëjtat dhe deklaroi se po këto pretendime janë trajtuar në aktvendimin kontestues një nga një dhe të të gjitha së bashku dhe pikërisht për faktin se nuk janë prezantuar prova të mjaftueshme dhe të harmonizuara nga ana e paditësit gjatë trajtimit të lëndës në procedurë administrative është refuzuar kërkesa e subjektit për rishqyrtimin e vendimit kontestues. Gjithashtu në seancën e datës 20.09.2024 përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit deklaroi se pas analizimit të aktgjykimit KF.nr.491/22 të datës 04.07.2024 në këtë seancë nga pala paditëse me të cilin është aprovuar në tërësi kërkesëpapia e paditësit dhe është anuluar aktvendimi 05.2.1/575;768/2011 i datë 29.04.2021, deklaroi se seanca e sotme për të cilën jemi thirrur ka të bëjë me çështjen e njëjtë pasi që zyra Doganore Hani i Elezit duke vepruar sipas aktvendimit 05.2.1/575;768/2011 i datës 29.04.2021 ka nxjerrë aktvendim të ri me nr. 2021/23037/1 të datës 23.11.2021 duke obliguar subjektin këtu paditësin që të kthejë vlerën e mjeteve 3,783.95 euro duke u bazuar në pikën tre të dispozitivit të aktvendimit 05.2.1/575;768/2011 të datës 29.04.2021 duke theksuar se kemi të bëjmë me rast të njëjtë i cili tashmë është trajtuar nga Gjykata Komerciale me nr.KF.nr.491/22. Andaj le të mbetet në vendosje të gjykatës lidhur me këtë kontest.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik ka administruar provat si në vijim: Aktvendimi 2021/23037/1 i datës 23.11.2021, dëftesë për pagesën e detyrimeve tatimore e datës 06.06.2014, Aktvendim 01.3.2.2/25998 i datës 14.02.2022, Ankesë në doganë 31.12.2021, Aktvendim 07.4/389,492,575, 768 datë 04.04.2014, Aktgjykim A.nr.1366/18 , Faturë 300001 1259 e datës 10.05.2011,

Aktgjykim KF.nr.491/22, Aktvendimi 05.2.1/575,768/201 1 i datës 29.04.2021, DUD-at 41655, 21688, 23232, 23339, 27108, 33136, 20969, 24978, 34401, 36486, 37143 06125223 faturat e DUD a-ve kontestues, CMR, EUR 1, DV 1, proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, pagesat bankare ndërkombëtare te datës 29.04.201 1, 04.05.2011, 10.05.2011, 17.05.2011 11.05.201 1. 27.05.2011, 6.06.2011, 21.06.2011. 07.07.2011. 12.07.2011, 14.07.2011. 25.07.201 1, 28.07.201 1, 1 1.08.201 1, 12.08.2011, 16.08.2011, 29.11.2011, 08.09.2011 aktvendimi 05.2.1/575, 768 e datës 10.08.2011, aktvendimi 07.4/389, 492, 575, 768 i datës 04.04,2014 aktvendimi A.nr.287-DK-2011 i datës 07.02.2014 aktvendimi 05.2.1/313-329, 371 dhe 376 i datës 29,06.2012 ankesa e ushtruar ne BPR, ekspertiza financiare e datës 03.06.2024, pagesa bankare e detyrimeve doganore e datës 21.04.2022.

Gjykata, pasi shqyrtoi pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të aktgjykimit KF.nr.491/22 të dorëzuar nga pala paditëse në seancën e datës 20.09.2024, konstatoi se aktgjykimi në fjalë, ndonëse i referohet të njëjtave deklarata unike doganore si ato të trajtuara në aktgjykimin KF.nr.491/22, konstaton se aktvendimet përfundimtare nuk janë të njëjta. Për më tepër, deri në datën e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, aktgjykimi KF.nr.491/22 nuk është bërë i formës së prerë. Për këtë arsye, gjykata nuk mundi të veprojë sipas dispozitave të nenit 34 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, i cili decidivisht përcakton rastet kur gjykata mund të hedhë kërkesëpaditë e ku sipas paragrafit 1.6 të këtij neni, kërkohet që "*të ekzistojë një vendim i formës së prerë, i nxjerrë në konfliktin administrativ për të njëjtën çështje.*". Ndërsa, në paragrafin 2 të nenit 34, përcaktohet se "*gjykata mund të hedhë poshtë padinë në çdo fazë të procedurës për shkaqet e parashikuara në paragrafin 1.*". Meqenëse kushtet ligjore sipas paragrafit 1.6 nuk janë plotësuar, gjykata vendosi që çështja të trajtohet në mënyrë meritore, në përputhje me nenin 43 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, paragrafi 1.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, deklarimeve në seancë, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, dhe duke u mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest administrative, deklarimeve në padi dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka gjetur se në mes të palëve nuk ishte kontestuese se e paditura duke vepruar në rivendosje sipas aktgjykimit A.nr.1366/18 kishte refuzuar sërish

kërkesën e këtu paditësit për rishqyrtimin e Deklaratave Unike Doganore, nuk ishte kontestues as fakti se ndaj aktvendimit të marr në rivendosje nr. 1/575,768/2011 dt. 29.04.2021 paditësi kishte iniciuar konfliktin administrativ i cili në këtë Gjykatë evidentohet me nr. KF.nr.491/22, nuk ishte as kontestuese se Zyra Doganore Hani i Elezit duke vepruar sipas vendimit nr. 1/575,768/2011 dt. 29.04.2021, me aktvendimin nr. 2021/23037/1 dt. 23.11.2021 ka obliguar këtu paditësin t'ia kthej të paditurës shumën të cilën e paditura i kishte kthyer sipas vendimit të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim me nr. A.nr.226/2011-DK datë 14.02.2014, e ndaj të cilit aktvendim paditësi kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim të cilën këtu e paditura me aktvendimin kontestues nr.01.03.2.2/25998 i datës 14.02.2022 e kishte refuzuar, dhe ndaj të njëjtit paditësi ka hapur këtë konflikt administrativ.

Nga aktvendimi kontestues gjykata konstaton se Dogana e Kosovës ka konstatuar se kërkesa e subjektit është e pathemeltë për arsye se, Zyra Doganore Hani i Elezit 2. Duke vepruar sipas aktvendimit 1/575,768/2011 dt. 29.04.2021 ku subjektin në procedurë me aktvendimin e 21688/11.05.2011 e ka obliguar që te paguaj detyrimet doganore për deklaratat %23232/18.05.2011 1; %23339/19.05.2011; %627108/07.06.2011; 33136/07.07.2011, pasi që Gjykata e Apelit me aktgjykimin AA.nr 153/14 date 12.04.2018, ka aprovuar ankesën e ankuesit Dogana e Kosovës, duke anuluar aktvendimin A.nr.287/2011-DK date 07.02.2014 dhe A.nr.226/2011-DK datë 14.02.2014 të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim, dhe lëndën e ka kthyer në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative - Divizioni fiskal në rigjykim dhe rivendosje, ku Gjykata Themelore Prishtinë me aktgjykimin A.nr.1366/18 datë 11.02.2021 të njëjtën çështje e ka kthyer tek Dogana e Kosovës në rivendosje duke anuluar aktvendimin e Doganës se Kosovës- Aktvendimi 05.2.1/575, 768 date 10.08.2011, pra lënda është kthyer në pikën fillestare. Dogana e Kosovës në rivendosje sipas aktvendimit 052.1/575,768/2011 dt. 29.04.2021 pasi që analizuar të gjitha shkresat e lëndës për arsyet e cekura në aktvendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtimin e Deklaratave Unike Doganore %21688/11.05.2011; %623232/18.05.2011; 3339/19.05.2011; %27108/07.06.2011; %33136/07.07.2011 ku kanë mbetur në fuqi rivlerësimet e mallit lëndorë. Andaj ka konstatuar se Zyra Doganore Hani i Elezit, bazuar në aktvendimin 2021/23037/1 dt. 23.11.2021, ka vepruar drejtë kur ka obliguar subjektin që t'i kthej mjetet që janë kthyer nga dogana e Kosovës bazuar në aktvendimin A.nr.287/2011-DK date 07.02.2014 dhe A.nr.226/2011- date 14.02.2014 të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim i cili aktvendim tani është i anuluar.

Gjykata sqaron se ekzekutueshmëria e aktit administrativ është e rregulluar me nenin 43 të Ligjit nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative, ku në paragrafin e dytë përcakton se “ *Organi publik nuk do të ndërmarrë asnjë veprim ekzekutimi që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, pa lëshuar paraprakisht një akt administrativ, që është i bërë i ekzekutueshëm, përveç rastit të përmendur në nenin 153 të këtij Ligji.*” Ndërsa në nenin 153 është rregulluar ekzekutimi i menjëhershëm ku përcakton se: *1. Organi publik kompetent mund të përdorë njëri nga procedurat e ekzekutimit të parapara nga nenet 150 dhe 152 të këtij Ligji, edhe pa nxjerrë paraprakisht një akt administrativ, vetëm nëse plotësohen së bashku këto kushte: 1.1. për shkak të urgjencës së jashtëzakonshme akti administrativ që përmban një detyrim jo-financiar nuk mund të nxirret në kohën e nevojshme, dhe 1.2. është e nevojshme marrja e një mase urgjente për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, apo për të shmangur kërcënime a rreziqe të menjëhershme për jetën, shëndetin apo pronën e personave. 2. Çdo veprim i kryer për ekzekutimin e menjëhershëm, regjistrohet nga organi publik për ekzekutimin në një procesverbal. 3. Me kërkesë të palës, organi publik që ka kryer ekzekutimin e menjëhershëm, duhet të nxjerrë aktin administrativ të munguar, sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda tetë (8) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Akti, në arsyetimin e tij, përfshin edhe arsyet e ekzekutimit të menjëhershëm. 4. Afati për parashtrimin e kërkesës sipas paragrafit 3 të këtij neni, është dy (2) muaj nga dita e ekzekutimi.*

Gjykata vlerëson se e paditura nuk ka vepruar konform dispozitave të parapara të procedurës administrative, pasi aktvendimi nr. 052.1/575,768/2011, datë 29.04.2021, ende pa u bërë i formës së prerë, ka nxjerr aktvendimin 2021/23037/1, datë 23.11.2021, nga ZD Hani i Elezit, i cili ka obliguar paditësin të kthejë mjetet që dogana i kishte kthyer më parë, në bazë të Aktvendimit të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim me nr. A.nr.226/2011-DK datë 14.02.2014. Megjithëse ky aktvendim ishte anuluar dhe nuk ishte përfundimtar, pasi Gjykata e Apelit e kishte kthyer lëndën në rivendosje, kompetenca për rivendosje i takonte Divizionit Fiskal të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në kuadër të Departamentit Administrativ, i cili sërish e kishte kthyer lëndën për rivendosje tek e paditura. Në këtë rivendosje, e paditura kishte refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e DUD-ave kontestues, por ky aktvendim nuk ishte përfundimtar dhe nuk ishte bërë i ekzekutueshëm, duke qenë tashmë i anuluar me aktgjykimin KF.nr.491/22.

Nga kjo gjendje faktike, gjykata vlerëson se aktvendimi nr. 2021/23037/1 i datës 23.11.2021 nuk është marrë në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë ekzekutueshmërinë e aktit

administrativ, dhe se vërtetimi i tij sipas aktvendimit përfundimtar nr. 01.3.2.2/25998 është i gabuar. Për këtë arsye, gjykata vendosi që ky aktvendim të anulohet me këtë aktgjykim.

Gjykata nuk u lëshua në elaborimin e Deklaratave Unike Doganore dhe provave të tjera të administruara, meqenëse aktvendimi kontestues i referohet vetëm aktvendimit me të cilin e paditura kishte urdhëruar paditësin që të bëj kthimin e mjeteve të kthyer paditësit me aktvendimin 07.4/389,492,575,768 të datës 04.04.2014.

Gjykata kërkesën e paditësit për kthimin e mjeteve respektivisht shumës 3,783.95 € e hedhi poshtë me arsyetim se kjo kërkesë tashmë është trajtuar në Aktgjykimin KF.nr.491/22. Rrjedhimisht, Gjykata konform nenit 391 të LPK-së sipas të cilit padia mund të hedhet kur : “c) *për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispendenca)*” vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata vendosi në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 64 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA).

Nga të lartcekurat, gjykata konform, nenit nenit 43 par 1 dhe 46 par 1 dhe 2 të LKA-së si dhe nenit 391 pika c, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Fiskale

KF.nr.699/22, datë 20.09.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.